



UNMIK

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
INSTITUCIONET E PËRKOQSHME TË VETËQEVERISJES  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA  
MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE/TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO  
MINISTRIA PËR EKONOMI DHE FINANCA/ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS  
MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE/PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA



## UDHËZIM ADMINISTRATIV

Nr. 05/2005, Datë 29.04.2005

**MBI**

**IMPLEMENTIMIN E LIGJIT Nr. 2004/48**

**‘MBI**

**ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT’**

Në përputhje me nenin 60 të Ligjit Nr. 2004/48 “Mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat” të nxjerrë përmes Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/17, Ministria e Financave dhe Ekonomisë jep Udhëzimin Administrativ vijues për implementimin e këtij Ligji:

### Neni 1 Përkufizimet

‘Ligj’ nënkupton Ligjin Nr. 2004/48 “Mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat”.

‘MFE’ nënkupton the Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

‘Rregullorja’ nënkupton Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2005/17 “Mbi Nxjerrjen e Ligjit mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat”.

‘ATK’ nënkupton Administratën Tatimore të Kosovës.

### Neni 2 Deklaratat tatimore

Neni 1.1 i Ligjit përfshinë definicionin e “deklaratës tatimore” që është relevant për qëllime të ndëshkimeve për deklaratat tatimore të dorëzuara me vonesë apo të mosdorëzuara dhe për deklaratat tatimore të pasakta. Deklaratë tatimore nënkupton çdo formular tatimor të dorëzuar për çdo lloj tatimi të implementuar në Kosovë që nga viti 1999 që administrohet nga ATK, përfshirë formularët për tatimet në burim dhe kontributet pensionale të vjelura nga ATK, por duke përjashtuar:

- formularët tatimor të përdorur për pagesat e kësteve për tatimin në fitim, tatimin në të ardhurat e korporatave dhe tatimin në të ardhurat personale (në lidhje me bizneset

të cilat kërkohet ose vendosin të paguajnë tatimin mbi fitimin “real” e jo në bazën e paragjykuar) – këta formularë do të konsiderohen si pagesë tatimore e jo deklarata tatimore por aty ku formularët e tillë janë dorëzuar me vonesë, ndëshkimet për pagesë me vonesë dhe interesi do të aplikohen.

- formularët tatimor të përdorur në lidhje me tatimet e vjelura nga agjentët mbledhës të ATK-së, domethënë Shërbimi Doganor i UNMIK-ut (për TVSh-në në importe) dhe Njësia për Regjistrimin e Automjeteve e Ministrisë së Shërbimeve Publike (për tatimin në rrugë për automjete).

### Neni 3

#### Administrata Tatimore e Kosovës (ATK)

Neni 2.1 i Ligjit specifikon se ATK do të ketë statusin e një Agjencioni Ekzekutiv dhe po ashtu i atribuon ATK-së ‘*autonomi të plotë operationale*’ përbrenda MFE-së. Kuptimi i kësaj shprehje është se MFE do të vazhdojë të ketë një rol ekskluziv në formulimin e të hyrave të përgjithshme dhe politikat tatimore për qeverinë dhe ATK do të vazhdojë të japë të dhëna statistikore të nevojshme për këtë formulim. Administrimi i tatimeve nga perspektiva operationale do të jetë tërësisht autonome dhe jashtë kontrollit të Ministrit të MFE-së me përjashtime të caktuara të cilat janë të specifikuara në Ligj sikurse janë:

- involvimi në emërimin e Drejtorit të ATK-së;
- involvimi në emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtime përmes të qenurit anëtar i Qeverisë;
- miratimi i shlyerjes së detyrimeve tatimore në përputhje me rregullat e specifikuara në Ligj dhe këtë Udhëzim Administrativ; dhe
- miratimi dhe publikimi i shkallëve të interesit për pagesa me vonesë të tatimit dhe rimbursimet e vonuara.

Neni 2.3 i Ligjit specifikon se ATK do të vjel të hyrat më të larta të mundshme praktike por duke pas parasysh burimet në dispozicion për ATK, ngritjen e përmbushjes me ligjet tatimore (posaçërisht përmbushjes vullnetare), dhe shpenzimeve të përmbushjes së tatimpaguesve. Shprehja ‘*vjelja e të hyrave më të larta që janë praktike*’ nuk duhet të lexohet e veçantë dhe ATK nuk duhet të shpërdorë autorizimet e saja vetëm e vetëm të arrijë caqet e të hyrave. ATK duhet gjithashtu të marrë parasysh shpenzimet e vjeljes dhe nuk duhet të shpërfill shpenzimet e përmbushjes të tatimpaguesve.

### Neni 4

#### Drejtori i ATK

Nenet 3.1 dhe 3.2 të Ligjit specifikojnë se procesi i emërimit dhe shkarkimit të Drejtorit të ATK-së do të kalojë përmes tri shkallëve vijuese: Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Qeveria dhe PSSP. Ministri i MFE-së do të bëjë një rekomandim për emërimin e Drejtorit të ri vetëm nëse propozimi paraprak për shkarkimin e Drejtorit ekzistues është prezantuar dhe është dhënë evidencë e mjaftueshme se shkarkimi është për shkak të shkeljeve të cekura në Nenin 3.2 të Ligjit, apo pozita është e zbrazur, apo është dhënë dorëheqje e parevokueshme nga Drejtori ekzistues. Shkallët më të larta mundën gjithnjë të refuzojnë propozimin e bërë nga shkalla më e ulët.

Të gjitha autorizimet, punët dhe detyrat e vëna me Nenin 3.3 të Ligjit mbi Drejtorin e ATK-së dhe aty ku ai/ajo vendos t'u delegojë vartësve të tij/saj sipas Nenit 7.1, nga 1 Maji 2005, janë të përfshira në Matricën e Delegimit e cila i është bashkëngjitur si Aneks këtij Udhëzimi Administrativ. Ndryshimet në të ardhmen në matricën e Delegimit mund të bëhen nga Drejtori i ATK-së pa pasur nevojën të freskojë këtë Udhëzim Administrativ.

#### Neni 5

##### Vendimet shpjeguese publike

Neni 9.4 i Ligjit specifikon se Vendimet Shpjeguese Publike të lëshuara nga Drejtori i ATK-së nuk janë detyruese për personat që janë të detyruar të paguajnë tatimin sipas ligjit të aplikueshëm në Kosovë. Kjo nënkupton se personat që janë të detyruar për tatime e të cilët nuk pajtohen me përmbajtjen e vendimeve shpjeguese publike janë të lirë të përdorin një interpretim tjetër të legjislacionit tatimor. Drejtori i ATK-së nuk mundet t'i detyrojë personat që detyrohen për tatim të jenë të detyruar përmes vendimeve shpjeguese publike por ai/ajo do të sigurohet që zyrtarët tatimor të ATK-së të ndjekin vendimet shpjeguese publike të lëshuara nga ATK.

#### Neni 6

##### Vendimet shpjeguese individuale

Neni 10.2 i Ligjit specifikon se vendimet shpjeguese individuale lëshohen kur tatimpaguesit individualisht kërkojnë interpretim të dispozitave tatimore të veçanta në lidhje me rastet e veçanta praktike. Vendimet e tilla shpjeguese individuale janë detyruese si për ATK-në ashtu edhe për tatimpaguesit që kërkojnë vendime të tilla vetëm deri në masën sa tatimpaguesi ka treguar tërësisht dhe realisht faktet dhe aspektet e posaçme të rastit që ai/ajo kërkon të interpretohet në lidhje me dispozitat e aplikueshme tatimore. Por nëse tatimpaguesi kërkon një interpretim të përgjithshëm të dispozitës së dhënë të legjislacionit tatimor pa bërë ndonjë referencë për një rast të posaçëm ATK mund të japë këshillë jodetyruese dhe/ose, nëse është e duhur, të lëshojë një vendim shpjegues publik për atë dispozitë.

#### Neni 7

##### Krijimi dhe mbajtja e regjistrimeve

Neni 12.2.a i Ligjit specifikon se tatimpaguesit, personat e tatuueshëm dhe agjentët e mbajtjes në burim kërkohet të krijojnë dhe mbajnë regjistra për një periudhë prej së paku 6 vjet pas përfundimit të periudhës tatimore në të cilën detyrimi tatimor ka lindë. Meqë periudhat e mbajtjes së librave dhe regjistrimeve dallohen për lloje të ndryshme të tatimeve përpara miratimit të Ligjit, kjo dispozitë do të ketë efekt për periudhat që fillojnë me ose pas 1 Majit 2005. Për periudhat tatimore që kanë filluar para 1 Majit 2005 periudhat e mbajtjes të specifikuara në legjislacionin tatimor përkatës do të vazhdojnë të kenë efekt.

#### Neni 8

##### Qasja në libra, regjistrime, kompjuterë dhe pajisje tjera të ngjashme për ruajtjen e regjistrimeve

Neni 13.1 i Ligjit specifikon se si rregull të përgjithshëm, ATK do t'u japë njoftim paraprak tatimpaguesve mbi qëllimin e saj t'i qaset objekteve të biznesit të tyre dhe/ose t'i verifikojë librat dhe regjistrimet e tyre. Në atë rast, ATK do të japë njoftim parak minimum prej 3 ditëve

Një përjashtim në këtë rregull të përgjithshëm aplikohet në *'rrethana përjashtuese që për mendimin e Drejtorit kërkohet ndryshe'* aty ku ATK mund të ketë qasje të plotë dhe të lirë në çdo objekt ku kryhet puna, libër, regjistrim, kompjuter ose pajisje të ngjashme për ruajtjen e regjistrimeve pa dhënë njoftim paraprak. Rrethanat e tilla përjashtuese do të dalin vetëm aty ku Drejtori konkludon se qasja mund t'i sigurojë atij/asaj materiale relevante për ndonjë obligim tatimor dhe të ushtrohet në situatat sikurse janë, por nuk kufizohet në to:

- ATK posedon informata se tatimpaguesi synon të fsheh, manipulojë apo shkatërrojë tatimin ose evidencë tjetër financiare sikurse janë librat, regjistrat, rezervat e mallrave, etj
- ATK ka indikacione se tatimpaguesi synon të lëshojë Kosovën duke lënë obligimet tatimore të pashlyera. Evidenca e tillë mund të përfshijë kërkesën për vizë në një ambasadë të huaj, një tërheqje të pazakonshme ose transfer tjetër bankar të parave jashtë vendit, etj;
- ATK posedon informata se faktet e raportuara nga tatimpaguesi janë shumë larg nga e vërteta dhe saktësia – kështu qasja e menjëhershme tek objektet, librat dhe regjistrimet e tatimpaguesit mund të rezultojë në evidencë materiale për të rindërtuar tërë gjendjen tatimore dhe për të përcaktuar detyrimin tatimor.

Nevoja për të dhënë njoftim paraprak gjithashtu nuk do të jetë e nevojshme aty ku tatimpaguesi fton ose përndryshe lejon ATK-në të vizitojë objektet e tija të biznesit, p.sh. për vizitë edukative.

#### Neni 9

##### Vlerësimi, Vetë-vlerësimi dhe mekanizmat e mbajtjes në burim

Në përputhje me Nenin 16.1 të Ligjit, si parim i përgjithshëm në Kosovë tatimet kryesisht do të vetë-vlerësohen. Vetë-vlerësim nënkupton se tatimpaguesit, dhe ata që kërkohet të mbajnë në burim tatimet në emër të tjetërkujt, e kanë për detyrë të llogarisin detyrimin e tyre tatimor dhe kjo do të konsiderohet si një vlerësim i tatimit për pagesë dhe sa duhet. ATK do të përpiqet të ndihmojë tatimpaguesit të vetë-vlerësojnë, por nuk ka arsytim për tatimpaguesin të thotë se nuk është i detyruar për tatim thjeshtë sepse nuk është informuar nga ATK.

#### Neni 10

##### Kufizimet kohore për vlerësimet

Neni 18 i Ligjit specifikon kufizimet kohore për ATK-në në kryerjen e një vlerësimi. Kjo është vënë me 6 vjet nga data kur deklarata tatimore për të cilën është bërë vlerësimi ka qenë obligim. Për shembull, një deklaratë tatimore e TVSh-së për muajin Tetor 2005 është obligim deri më 30 Nëntor 2005. ATK mundet të bëjë një vlerësim sipas Neneve 17 ose 19 më ose përpara 30 Nëntorit 2011. Por nëse tatimpaguesi, me synim të evazionit

tatimor, qoftë duke mos dorëzuar deklaratën tatimore ose e dorëzon një deklaratë tatimore që është përcaktuar si e pasaktë, ose kryen vepër mashtrimi, kufizimi kohor i sipërm nuk ka fuqi dhe mund të bëhet vlerësim kurdo.

#### Neni 11

##### Vlerësimi në rast rreziku

Në rastet kur Drejtori i ATK-së vendos të bëjë një vlerësim rreziku sipas Nenit 19 të Ligjit, do të lëshohet një Njoftim i Vlerësim Rrezikut. Njoftim i Vlerësim Rrezikut do të përmbajë të gjitha detajet e specifikuar në Nenin 20 të Ligjit plus një kërkesë për pagesë të menjëhershme të shumës obligative. Një njoftim i vlerësim rrezikut gjithashtu duhet të përfshijë një shënim për tatimpaguesin mbi të drejtën e tatimpaguesit që drejtpërdrejt të ngrejë ankesë në Bordin e Pavarur për Rishqyrtime.

#### Neni 12

##### Urdhër-pagesat

Neni 23.1 i Ligjit specifikon nocionin e urdhër-pagesave, e që është relevant posaçërisht kur të jetë bërë një pagesë e pjesshme. Për shembull, një tatimpagues ka një detyrim tatimor gjithsej 1,000 euro në TVSh, si vijon: 600 euro TVSh + 200 euro ndëshkime + 200 euro interes. Administrata Tatimore konfiskon një aset të borxhliut dhe e shet përmes ankandit publik për 1,000 euro. Kostoja administrative për konfiskimin, shërbimet e ruajtjes, transportimi dhe shpenzimet e ankandit është 100 euro. Duke përcjellë rendin e pagesave të specifikuar në Nenin 23.1 të Ligjit rezultati do të jetë:

1. Shpenzimet e mbledhjes -	100 euro
2. Ndëshkimet -	200 euro
3. Interesi -	200 euro
4. Tatimi -	600 euro
5. Gjithsej	1,100 euro
Minus shuma e mbledhur	1,000 euro

---

Bilanci i mbetur i obligimit tatimor 100 euro

#### Neni 13

##### Kreditimet dhe rimbursimet

Sipas Nenit 24.4 të Ligjit, tatimpaguesit të cilët kërkojnë rimbursim për tatimet e paguara më tepër apo me gabim do të dorëzojnë një Formular të Kërkesës për Rimbursim në zyrën tatimore të juridiksionit të tyre. Kërkuesi do të sigurojë të dhëna specifike që lidhen me kërkesën sikur që është shuma e tatimit të kërkuar si rimbursim, lloji i tatimit, periudha tatimore në të cilën është paguar tatimi tepër ose me gabim, banka dhe llogaria bankare ku ai/ajo dëshiron që rimbursimi t'i bartet.

Administrata Tatimore do të përpiqet të kompletojë përpunimin e kërkesës për rimbursim brenda 60 ditëve nga data kur është dorëzuar kërkesa për rimbursim. Për të shmangur procedurat burokratike në lidhje me kërkesat e vogla, kërkesat për rimbursim për shumat e vogla dhe ato që i përkasin tatimpaguesve me rrezik të vogël (d.m.th. atyre që kanë

histori të suksesshme të kërkesave të pranueshme në të kaluarën) do të përpunohen menjëherë duke verifikuar vetëm regjistrimet në dispozicion të Administratës Tatimore dhe jo edhe librat dhe regjistrimet e tatimpaguesit. Administrata Tatimore mban të drejtën që më vonë të kontrollojë regjistrimet e tatimpaguesit dhe nëse gjendet se tatimpaguesi nuk ka pasur të drejtë për atë rimbursim, ndëshkimet dhe interesi do të aplikohen mbi shumën e rimbursimit të kërkuar dhe të përpunuar me gabim në të njëjtën mënyrë sikur të ishte obligim tatimor dhe për pagesë ndaj ATK-së.

#### Neni 14 Barrët

Një barrë e dorëzuar nga ATK në përputhje me Nenin 27 të Ligjit është një instrument detyrues për të detyruar tatimpaguesin të paguajë detyrimet tatimore të pashlyera. Duke vënë një barrë mbi një pasuri të tatimpaguesit borxhli, ATK sigurohet se pasuria nuk do të transferohet, shitet apo të ekspozohet për shitje nga tatimpaguesi. Një barrë mund të dorëzohet në secilën zyrë përgjegjëse për regjistrimin e pronës në Kosovë sikur Agjencioni Kadastral i Kosovës, Regjistri i Banesave, Njësia për Regjistrimin e Automjeteve, Regjistri i Transaksioneve të Siguruara, etj., dhe tregon se pronari i pasurisë i ka një borxh tatimor ATK-së. Zyrat e regjistrimeve të sipërpërmendura kërkohet të regjistrojnë çdo transaksion në lidhje me atë pasuri për të cilën është dorëzuar barra derisa të jenë lajmëruar zyrtarisht për lirim nga barra nga ATK.

#### Neni 15 Urdhër-vjeljet

Një urdhër-vjelje është instrument konfiskimi përmes së cilës të drejtat e pronësisë mbi pasurinë, pronën apo të ardhurat transferohen nga tatimpaguesit borxhlinj në ATK. Sipas nenit 28 të Ligjit ATK ka të drejtë të shesë përmes ankandit publik çdo pasuri gjësend të konfiskuar dhe të zbatojë paratë nga shitja ndaj detyrimit të tatimpaguesit borxhli. Çdo aksion për të vjelur tatimet përmes urdhër-vjeljeve duhet të fillojë brenda 6 vjetëve pasi të jetë bërë vlerësimi i tatimit. Ky kufizim kohor shtyhet pakufizim nëse është inicuar një rast në gjyq qoftë nga tatimpaguesi apo ATK.

#### Neni 16 Fshirja e tatimit që nuk mund të mblidhet

Në lidhje me Nenin 36 të Ligjit, rrethanat kur ATK konsideron se tatimi është i pambledhshëm dhe si i tillë duhet të fshihet, janë me sa vijon:

- tatimpaguesi ka vdekur dhe nuk ka perspektivë që ajo të arkëtohet nga prona e tatimpaguesit;
- tatimpaguesi ka lëshuar përgjithmonë Kosovën;
- tatimpaguesi ka falimentuar dhe paratë nga procesi i insolvencës apo likuidimit nuk mund të plotësojnë në tërësi borxhet ndaj ATK-së;
- ATK vazhdimisht ka dështuar të gjejë tatimpaguesin e involvuar;
- ATK vazhdimisht është përpjekur por ka dështuar të detyrojë vjeljen e borxhit tatimor, dhe rrethana tjera të ngjashme.

Çdo propozim për MFE-në që të fshijë ndonjë detyrim tatimor do të bëhet me shkrim dhe duhet të propozohet nga një komision prej tre anëtarëve i kryesuar nga Drejtori i ATK-së.

Çdo propozim për të rivendosur një detyrim të fshirë gjithashtu do t'i jepet MFE-së dhe do të bëhet vetëm aty ku tatimpaguesi ka keqparaqitur faktet para vendimit për fshirje. Detyrimi tatimor që është fshirë nuk mund të rivendoset aty ku arsye e vetme për rivendosjen e tillë është se tatimpaguesi ka marrë të ardhura pas vendimit për fshirje, përveç nëse është e qartë se tatimpaguesi ka pas të drejtë të marrë ato të ardhura në kohën e vendimit për fshirje.

#### Neni 17

##### Të ardhurat ilegale

Sipas Nenit 37 të Ligjit çdo e ardhur që ka dalë nga veprimtaritë ilegale dhe/apo kriminale të dënueshme sipas legjislacionit të Kosovës, i nënshtrohet tatimit. Trajtimi i tillë nuk nënkupton se këto veprimtari janë të legalizuara duke paguar tatimet përkatëse. Këto veprimtari do të mbeten ilegale dhe ndiqen penalisht sipas legjislacionit të Kosovës.

#### Neni 18

##### Ri-karakterizimi i marrëveshjeve

Sipas Nenit 38 të Ligjit, ATK mundet të ri-karakterizojë marrëveshjet në mes të tatimpaguesve aty ku:

- nuk ka efekt thelbësor ekonomik p.sh. një tatimpagues në mënyrë të vazhdueshme shet me një çmim të ulët sesa çmimi i blerjes.
- forma e transaksionit nuk reflekton substancën e tij ekonomike. p.sh. një tatimpagues i dhuron mallra një institucioni bamirësie të financuar nga ai dhe merr zbritje të kontributeve për qëllime të tatimeve në të ardhura, dhe institucioni bamirës i shet mallrat me vlerën e tregut pa qenë i nënshtuar tatimit.
- është vendosur një skemë për të shmangur tatimet.

#### Neni 19

##### Nëndeklarimi i të ardhurave dhe arkëtimet e shmangura

Sipas Nenit 41 të Ligjit, ATK ka autoritet të rivendosë të ardhurat e tatimpaguesve standardi i jetesës së të cilëve nuk përputhet me të ardhurat e deklaruara sipas legjislacionit tatimor në Kosovë. p.sh. aty ku tatimpaguesi deklaron se nuk ka pasur të ardhura gjatë periudhës tatimore dhe në ndërkohë fillon ndërtimin e një shtëpie të shtrenjtë ose blen një automjet të shtrenjtë (financimi për të cilat nuk mund t'i atribuohet të ardhurave të patatueshme sikurse është marrja e një gjësendi të trashëguar, parave të dërguara nga të afërmit jashtë vendit, etj), ATK mundet të rillogarisë të ardhurat e tatimpaguesit duke e trajtuar atë sikur të ketë marrë shumën e të ardhurave të investuara.

#### Neni 20

##### Mosdorëzimi i deklaratës tatimore

Sipas Nenit 43 të Ligjit, ndëshkimi për mosdorëzim të deklaratës tatimore me kohë është vendosur me 5% në muaj ose pjesë të muajit të vonesës me një maksimum prej 25% të vendosur si kapak. Nëse për shembull një deklaratë e TVSh-së me një obligim tatimor prej 1,000 euro është dashur të kryhet deri më 31 Maj 2005 dhe është dorëzuar më 19 Dhjetor 2005, shuma e këtij ndëshkimi do të jetë 5% për Qershor + 5% për Korrik + 5% për Gusht + 5% për Shtator + 5% për Tetor = 25% x 1,000 euro = 250 euro. Nuk do të vazhdojnë të aplikohen ndëshkimet për Nëntor dhe Dhjetor 2005. Kuptimi i shprehjes 'pjesë e muajit' i referohet periudhave më të shkurta se muaji kalendarik dhe përfshinë rastet vijuese: fjala vjen, një deklaratë tatimore do të duhet të dorëzohet më 15 Maj 2005 dhe është dorëzuar më 6 Qershor 2005. Ndëshkimi do të aplikohet dhe mbetet në të njëjtin nivel prej 5% për periudhën 16 deri 31 Maj 2005 dhe do të aplikohet dhe mbetet në të njëjtin nivel prej 5% për periudhën 1 Qershor deri 6 Qershor 2005. Ose, nëse një deklaratë tatimore duhet të dorëzohet më 30 Shtator 2005 dhe është dorëzuar më 1 Tetor 2005, ndëshkimi do të aplikohet me nivelin e njëjtë prej 5% për vonesë për pjesë të muajit.

#### Neni 21

##### Mospagesa

Sipas Nenit 44 të Ligjit, ndëshkimi për mospagesë me kohë është vënë me 2% në muaj ose pjesë të muajit të vonesës me një maksimum prej 12 muajve si kapak. Nëse për shembull një deklaratë e tatimit në të ardhura me një obligim tatimor prej 1,000 euro është dashur të kryhet deri më 31 Mars 2006 dhe është dorëzuar më 20 Maj 2007, shuma e këtij ndëshkimi do të jetë 12 muaj x 2% x 1,000 euro = 240 euro. Kështu, nuk do të vazhdojë të aplikohet për Prill dhe Maj 2007. Shprehja 'pjesë e muajit' ka të njëjtin kuptim si në Nenin 21 më lartë.

#### Neni 22

##### Nëndeklarimi i tatimit dhe mbideklarimi i rimbursimeve tatimore

Në lidhje me Nenin 45.1.a të Ligjit, shprehja 'neglizhencë ose pakujdesi e madhe' do t'i referohet rasteve kur është bërë diçka, ose nuk është bërë, në mënyrën që sugjeron ose lë të kuptohet një nivel i lartë i mospërfilljes për pasojat, sikurse janë ato në vijim:

- një tatimpagues, gjatë kohës së llogaritjes së detyrimit të tij tatimor ose kërkesës për rimbursim, me hamendje trajton tatimin për artikuj të caktuar se sa të kërkojë këshillë nga ATK ose një këshilltar tatimor;
- një tatimpagues, gjatë kohës së llogaritjes së detyrimit të tij tatimor ose kërkesës për rimbursim, ka përjashtuar në mënyrë të pavëmendshme dhe paqëllimshme shumë artikuj ose artikuj të rëndësishëm nga, ose ka përfshirë shumë artikuj ose artikuj të rëndësishëm më shumë se një herë, deklaratat e tij tatimore;
- një tatimpagues ka mbajtur libra dhe regjistrime të duhura por nuk ka pasur vëmendje të mjaftueshme gjatë një periudhe kohore për të siguruar se çdo gjë është regjistruar dhe është hamendur për shumatat e pa regjistruara.

Shumica e gabimeve që rezultojnë nga neglizhenca dhe pakujdesia e madhe janë për shkak të mungesës së dijes mbi çështjet tatimore ose mungesës së vëmendjes gjatë llogaritjes së detyrimeve tatimore por ato nuk reflektojnë një sjellje të qëllimshme për të



shmangur ose zvogëluar tatimet. Neglizhencë ose pakujdesi e madhe nuk konsiderohet aty ku tatimpaguesi ka ndërmarrë hapat për të siguruar se deklaratat e tija tatimore janë korrekte por pa fajin e tyre gabimet prapë kanë dalë në ato deklaratat tatimore.

Në lidhje me Nenin 45.1.b të Ligjit, shprehja *'synim me paramendim dhe qëllim për të fshehur shumën e tatimit'* do t'i referohet rasteve sikurse janë ato në vijim

- një tatimpagues nuk ka mbajtur libra dhe regjistrime të duhura dhe nuk ka plotësuar deklaratat tatimore me rezultat ku gjendja tatimore është përcaktuar bazuar në regjistrimet dhe informatat e ATK-së;
- një tatimpagues qëllimisht ka përjashtuar disa fatura nga deklaratat e tija tatimore ashtu që të zvogëlojë shumën e një detyrimi tatimor, ose të rrisë shumën e një kërkesë për kreditim/rimbursim tatimor;
- një tatimpagues qëllimisht ka përfshirë fatura false për të rritur shumën e një kërkesë për kreditim/rimbursim tatimor, ose për të ulur shumën e një detyrimi tatimor.

Në lidhje me Nenin 45.2 të Ligjit, aty ku tatimpaguesi nuk dorëzon një deklaratë tatimore, ATK ka për detyrë të llogarisë detyrimin tatimor të tatimpaguesit bazuar në informatat më të mira që ATK posedon, për të rivendosur detyrimin tatimor që është dashur të deklarohet. Në këto raste ATK do të përgatisë një zëvendësim për deklaratën në emër të tatimpaguesit dhe për tatimpaguesin. Ndëshkimet do të aplikohen për pagesë të pamjaftueshme të tatimit në mes të shumës së tatimit të deklaruar nga ATK dhe shumës së tatimit të deklaruar nga tatimpaguesi e që do të konsiderohet të jetë zero.

### Neni 23

#### Moskrijimi dhe mosmbajtja e regjistrimeve

Neni 46.2 parasheh ndëshkime për personat të cilët nuk krijojnë ose nuk mbajnë regjistrime që kërkohen me ligjin e aplikueshëm të Kosovës. Shprehja *'pakujdesi e madhe'* do t'i referohet rasteve sikurse janë:

- një tatimpagues ka kryer biznes por nuk i ka mbajtur librat dhe regjistrimet dhe ka plotësuar deklaratat tatimor bazuar në vlerësime të përafërta (të dihet se tatimpaguesi nuk ka synuar të bëjë evazion në pagesën e tatimit por nuk ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për të siguruar se shuma e saktë e të ardhurave, dhe nëse është e nevojshme shpenzimet, janë regjistruar);
- një tatimpagues ka mbajtur libra dhe regjistrime por nuk ka treguar vëmendje të mjaftueshme gjatë një periudhe kohore për të siguruar se çdo gjë është regjistruar dhe me hamendje ka bërë shumat e pa regjistruara (të dini se tatimpaguesi nuk ka synuar të bëjë evazion në pagesën e tatimit, por nuk ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për të siguruar se shuma e saktë e të ardhurave – poashtu të dini se numri i rasteve të mosregjistrimit të transaksioneve ka qenë i kufizuar vetëm në një apo dy raste, dhe se veprimet e tatimpaguesit mund të konsiderohen si “pakujdesi” por jo “pakujdesi e madhe” në të cilin rast ndëshkimi për pakujdesi të madhe nuk do të aplikohet);
- një tatimpagues ka mbajtur librat dhe regjistrimet por me qëllim të ruajtjes së hapësirës ka gjuajtur regjistrimet në bërlllok dhe nuk i ka mbajtur ato për aq vite sa kërkohet.

Shprehja *'synim me paramendim për të shmangur pagesën e tatimit'* do t'i referohet rasteve sikurse janë:

- një tatimpagues ka kryer biznes por nuk ka mbajtur libra dhe regjistrime dhe nuk ka plotësuar deklaratën tatimore (të dini se ekziston supozimi duke pas parasysh sistemin e vetë-vlerësimit të tatimeve se në kësi rrethana tatimi është shmangur me paramendim – gjithashtu nëse ATK dëshiron të ndjek penalisht tatimpaguesin për evazion tatimor sipas Kodit Penal, do të mund të jetë e nevojshme evidencë shtesë nga ATK për të provuar synimin me paramendim);
- një tatimpagues ka mbajtur libra dhe regjistrime por ka rënë në dijeni se ai është afër inspektimit nga zyrtarët e ATK-së dhe se pastaj ka shkatërruar librat dhe regjistrimet.

#### Neni 24

##### Gabimet nga përfaqësuesit e tatimpaguesve dhe këshilltarët tatimor

Neni 48 i Ligjit parasheh për vënien e ndëshkimeve mbi përfaqësuesit e tatimpaguesve dhe këshilltarët tatimor në situata të caktuara. Detyrimi i përfaqësuesit të tatimpaguesit/këshilltarit tatimor për ndëshkimet e tilla është i kufizuar në vendimet e marra vetëm mbi informatat në dispozicion nga tatimpaguesi dhe palët e treta. Përfaqësuesi i tatimpaguesit/këshilltari tatimor nuk detyrohet nëse gabimet në deklaratat tatimore kanë qenë drejtpërdrejtë të atribuara veprimeve të tatimpaguesit për të cilat përfaqësuesi i tatimpaguesit apo këshilltari tatimor nuk ka qenë në dijeni.

Shprehja *'pakujdesi ose interpretim joreal të ligjeve tatimore'* do t'i referohet rasteve sikurse janë:

- një përfaqësues i tatimpaguesit/këshilltar tatimor ka përgatitur deklaratat tatimore për një tatimpagues por nuk ka treguar vëmendje të mjaftueshme gjatë llogaritjes së detyrimit tatimor ose kërkesës për rimbursim dhe si rezultat ka bërë gabime të paqëllimta matematikore të shumta dhe të rëndësishme;
- një përfaqësues i tatimpaguesit/këshilltar tatimor ka përgatitur deklaratat tatimore për një tatimpagues por gjatë llogaritjes së detyrimit tatimor ose kërkesës për rimbursim ka harruar të përfshijë artikuj të shumtë dhe të rëndësishëm, ose ka përfshirë artikuj të shumtë dhe të rëndësishëm më shumë se një herë;
- një përfaqësues i tatimpaguesit/këshilltar tatimor ka përgatitur deklaratat tatimore për një tatimpagues bazuar rregullat e kaluara të ATK-së dhe Gjykatës (nuk ka rast tjetër me fakte të ngjashme) që janë zëvendësuar me diçka të publikuar së voni e që është në kundërshtim me rregullat e ATK-së dhe Gjykatës.
- një përfaqësues i tatimpaguesit/këshilltar tatimor ka kërkuar të pranohen të gjitha shpenzimet e biznesit si zbritje nga të ardhurat pa verifikuar se a janë ato tërësisht të zbritshme për qëllime tatimore.

#### Neni 25

##### Shkeljet e TVSh-së

Nenet 49.1 dhe 49.2 të Ligjit parashohin ndëshkime për personat e tatueshëm të cilët (a) kryejnë furnizime të tatueshme derisa janë të paregjistruar e kur ata kërkohet të jenë ose

(b) nuk lëshojnë një faturë të TVSh-së ose lëshojnë një faturë të pasaktë të TVSh-së. Në ato nene, shprehja *'neglizhencë ose pakujdesi e madhe e personit të tatueshëm'* do t'i referohet rasteve sikurse janë:

- qarkullimi i një personi është rritur mbi pragun për regjistrim në TVSh, por nuk është regjistruar në TVSh sepse nuk ka qenë në dijeni se kohëve të fundit e ka kaluar pragun;
- një person i tatueshëm iu ka lëshuar fatura konsumatorëve të tij ku ka përfshi TVSh-në por ato fatura nuk i plotësojnë kërkesat e një fature të TVSh-së sepse personi i tatueshëm nuk ka dashur të ndryshojë sistemin e tij me qëllim të arritjes së kërkesave të TVSh-së.

Në ato nene, shprehja *'synim me paramendim dhe qëllim nga personi i tatueshëm'* do t'i referohet rasteve sikurse janë:

- qarkullimi i një personi është rritur mbi pragun e regjistrimit për TVSh, por ai me qëllim nuk është regjistruar në TVSh për të shmangur llogaritjen e TVSh-së;
- qarkullimi i një personi vazhdimisht ka qenë mbi pragun e regjistrimit për TVSh, por ai nuk është regjistruar për TVSh sepse nuk ka qenë në dijeni se kërkohet të regjistrohet – sipas sistemit të TVSh-së së Kosovës personat vlerësohet të jenë në dijeni për kërkesat kështu që mosregjistrimi i vazhdueshëm konsiderohet sikur një qëllim për mos t'u regjistruar;
- një person i tatueshëm iu ka lëshuar fatura konsumatorëve të tij por ato fatura nuk e kanë të përfshirë TVSh-së sepse personi i tatueshëm nuk dëshiron të aplikojë TVSh-në për konsumatorët e tij;
- një person i tatueshëm nuk iu ka lëshuar fatura konsumatorëve të tij ose vazhdimisht ka lëshuar fatura që nuk i plotësojnë kërkesat e një fature të TVSh-së sepse personi i tatueshëm nuk ka qenë në dijeni për kërkesat – sipas sistemit të TVSh-së së Kosovës personat e tillë do të vlerësohet të kenë qenë në dijeni për kërkesat kështu që mospërbushja e vazhdueshme konsiderohet sikur një qëllim për të mos përmbushur kërkesat.

Neni 49.5 i Ligjit parasheh një ndëshkim për personat të cilët gjendet të kenë mallra në posedim të tyre për të cilat nuk ka faturë të TVSh-së apo nuk ekziston regjistrim tjetër në lidhje me furnizimin. Ky ndëshkim për “mallrat pa origjinë” aplikohet tek ata persona të cilët janë të regjistruar për TVSh ose nuk janë të regjistruar për TVSh por kanë plotësuar kriterin ashtu që ata është dashur të jenë të regjistruar.

## Neni 26

### Ulja e ndëshkimeve

Neni 51.1 i Ligjit parasheh uljen e ndëshkimeve aty ku tatimpaguesit vullnetarisht paraqesin detyrimin tatimor që më herët nuk e kanë paraqitur përpara së ATK të fillojë një inspektim të veprimtarive të tatimpaguesit. Për qëllime të kësaj dispozite, një inspektim nuk ka filluar deri - në rastin e tatimpaguesit të cilit i është dhënë njoftim paraprak me shkrim sipas Nenit 13.1 - përpara (a) datës kur ai i jep regjistrimet, ose qasjen në regjistrime, zyrtarit të ATK-së dhe (b) datës që është një muaj pas datës kur njoftimi paraprak i është dhënë tatimpaguesit. Në rastin e tatimpaguesve të cilëve nuk u është dhënë njoftim paraprak sipas Nenit 13.1, inspektimi konsiderohet të ketë filluar në

datën që është një javë pas datës në të cilën një zyrtar i ATK-së së pari ka kontaktuar tatimpaguesin se do të kryej një inspektim.

#### Neni 27

##### Ankesat në ATK

Neni 52.3 i Ligjit parasheh që kufizimi kohor 60 ditë për ngritjen e ankesës në ATK sipas Nenit 52.2 mund të shtyhet në rrethana të caktuara. Rrethanat kur periudha 60 ditore mund të shtyhet janë atëherë kur ATK është e kënaqur që:

- arsyeja për mos dorëzim përbrenda kufizimit kohor është vetëm për shkak të faktorëve që janë jashtë kontrollit të tatimpaguesit;
- ose
- rrethanat janë të tilla ashtu që nëse nuk lejohet ngritja e ankesës do të rezultonte në një manifestimin e padrejtësie.

#### Neni 28

##### Hyrja në fuqi

Sipas Nenit 62 të Ligjit, Ligji hyn në fuqi më 1 maj 2005. aplikohet mbi ngjarjet që kanë ndodhur më ose pas asaj date. Për shembull:

- interesi për pagesë mbi rimbursimet e vonuara aplikohet vetëm për kërkesat e rimbursimit të bëra në ATK më ose pas 1 Majit 2005. (Kërkesat për rimbursim të bëra përpara asaj date e që janë vonuar nuk kanë të drejtë në interesin për vonesën që nuk i ka kaluar afati);
- uljet e ndëshkimeve për shkak të paraqitjes vullnetare ose përmbushjes përmes marrëveshjes me këste për të paguar borxhet tatimore aplikohet vetëm për paraqitjen vullnetare të bërë, dhe marrëveshjet me këste bëra, më ose pas 1 Majit 2005;
- dispozitat e ndëshkimeve të reja ose të ndryshuara aplikohen vetëm për shkeljet e kryera më ose pas 1 Majit 2005. (Shkeljet e kryera para 1 Majit 2005 por të zbuluara më ose pas asaj date do t'i nënshtrohen çdo lloj ndëshkimi sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/20).

Data: \_\_\_/\_\_\_/2005

Haki Shatri  
Ministër i Financave dhe Ekonomisë



## INSTRUMENTI I DELEGIMIT TË AUTORIZIMEVE

Në përputhje me Nenin 7.1 të Ligjit mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat (të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/17), më këtë unë i delegoj autorizimet që më janë caktuar mua sipas asaj Rregullore, zyrtarëve të Administratës Tatimore të Kosovës në përputhje me Tabelën e bashkëngjitur.

Mustafë Hasani  
Drejtor,  
Administrata Tatimore e Kosovës  
29 Prill 2005

**TABELA**

Autorizimi/Neni	ZV. Drejtor	Menaxher ZQ	Menaxh regj & Zv. Menaxh	Udheh. Ekipi	Zyrtar
Caktimi i Zëvendës Drejtorëve (4.1)					
Shkarkimi i Zëvendës Drejtorëve (4.3)					
Caktimi i menaxherëve të lartë (5.1)					
Shkarkimi i menaxherëve të lartë (5.3)					
Rregullat për zyrtarët tatimor (6)					
Revokimi i delegimit (7.2)					
Raportimi në MFE (8.1)	x				
Raporti vjetor (8.2)					
Vendimet shpjeguese publike (9.1)	x				
Vendimet shpjeguese individuale (10.1)	x				
Përdorimi i NIT (11.6)	x	x	x	x	x
NIT për Doganën (11.7)	x				
Përkthimi i regjistrimeve (12.1)	x	x	x	x	x
Ruajtja në mikrofilm (12.2(b))	x	x	x	x	
Periudhat e ndryshme tatimore (12.2(c))	x	x			
Qasja në objekte me njoftim (13.1)			x	x	x
Qasja në objekte pa njoftim (13.1)			x	x	
Kopjimi i regjistrimeve (13.3(a)&13.6)*			x	x	x
Marrja e regjistrimeve (13.3(b)&13.7)*			x	x	x
Mbajtja e regjistrimeve (13.3(c))			x	x	x
Kerkimi i passwordit (13.3(d))			x	x	x
Marrja e kompjuterit (13.3(e)&13.7)*			x	x	
Verifikimi i pasurise (13.3(f))			x	x	x
Pas orëve (13.4)*			x	x	
Letër autorizimi (13.5)*			x	x	

Përgatitja e regjistrimeve (14.1(a))			x	x	x
Të vijë në ATK (14.1(b))			x	x	
Zhvillojë formularë (15.2)	x	x			
Bëjë vlerësim (17.1) deri (17.4)			x	x	x
Të vlerësoj në cdo kohë (18.2)			x	x	
Vlerësimi në rrezik (19)			x	x	
Dorëzimi i njoftim-vlerësimit (20.1)			x	x	x
Kërkojë pagesën (20.4)			x	x	
Mbetja e vogël (21.7)	x				
Pranimi i pagesave tatimore (21.8)					
Publikimi i shkallës së interesit (22.3)	x	x			
Njoftimi i thyerjes së tatimit (24.1)			x	x	x
Mbetja e kreditimit tatimor (24.3)			x	x	x
Kërkesat për rimbursim (24.5) *			x	x	x
Interesi në rimbursime (24.6) *			x	x	
Marrëveshja bankare (25.1)					
Padia për tatimin e papaguar (26.1)	x		x		
Certifikata e tatimit të papaguar (26.2)			x	x	
Lëshimi i barrës (27.4)	x		x	x	
Dorëzimi i barrës për detyrim (27.5)	x		x	x	
Mbledhja me urdhërvjelje (28.1&28.8)			x	x	x
Dorëzimi i njfotimit për konfiskim (28.2&28.3)			x	x	x
Konfiskimi i pasurisë (28.5)			x	x	
Njoftimi /kërkesa në rrezik (28.6)			x	x	
Zbatimi i urdhërvjeljes (29.1 & 29.2)			x	x	x
Shitja përmes ankëndit (30)			x	x	
Arkëtimi nga ortakët (32.1)			x	x	x
Arkëtimi nga trupi i painkorporuar (32.2)			x	x	x
Urdhër-rreziku (33.1)			x	x	
Embargo në importe/eksporte (34.1)	x	x			
Prishja e embargos (34.2)	x	x			
Ndalesa për largim (35.1)			x	x	
Shtyrja e limitit kohor për largim (35.2)			x	x	
Fshirja e tatimit (36.1) *					
Kryerja e fshirjes (36.1(a))			x	x	x
Rivënia e detyrimit (36.2)			x	x	x
Rikarakterizimi i marrëveshjeve (38.1)			x	x	
Njoftimi i rikarakterizimit (38.2)			x	x	x
Caktimi i personave të lidhur (39.1)			x	x	
Rregullimi për personat e lidhur (39.2)			x	x	
Rregullimi i tregut të këmbimit (40.2)			x	x	
Rillogaritja e të ardhurave (41.1)			x	x	x
Kërkesa e autorizimit për qasje (46.3)			x	x	x
Themelimi i Departamentit të Ankesave (52.1)					
Vlerësimi/vendimi i kontestueshëm (52.1)	x	x	x	x	x
Marrja pjesë në Bordin e P.Rishqyrtime (54)	x	x	x	x	x
Mbajtja e parave nga konfiskimi (57.3)			x	x	

Rimbursimi i tatimit të paguar tepër (57.4) *			x	x	x
Nxjerrja e informatave konfidenciale (59)	x	x	x	x	x

\* Shënim:

- (1) "x" cakton titujt e pozitave që i janë dhënë autorizimet e deleguara, dhe kjo vlen si për njerëzit që vërtetë dhe ata "ushtrues" janë në ato pozita. Aty ku nuk ka "x", autorizimi I Drejtorit nuk është deleguar
- (2) Udhëheqësi i Ekipit dhe Inspektorët e Njesisë së Kontrollit Special në ZQ të ATK do të kenë autorizimin të njëjtë të deleguar sikurse kolegët e tyre në zyrat regjionale të ATK
- (3) Në versionin zyrtar të ligjit, nenet 13.4 deri 13.7 mund të jenë të paraqitur si nene 13.3(g) deri 13.6
- (4) Delegimet për rikthim të parave për tatimpaguesit sipas neneve 24.5, 24.6 dhe 57.4 poashtu i nënshtrohen kontrolleve të delegimit financiar (p.sh.zyrtarët autorizues dhe miratues)
- (5) Delegimi për fshirjen e tatimit sipas nenit 36.1 është i përcaktuar në atë nen të ligjit (p.sh. çdo i punësuar mund të rekomandojë fshirjen por të gjitha rekomandimet duhet të shqyrtohen nga një komision prej 3 të punësuarve, përfshirë Drejtorin dhe një Zëvendës Drejtor)